

|   |   |   |
|---|---|---|
|  | Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti<br>Republika Kosovo-Republic of Kosovo<br>Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës<br>Opština Mamuša-Municipality of Mamusa |  |
| Çikis - Dalëse - Izlazna - Outgoing   |   |   |
| 01  | No.Nr. 018 - 22   |   |
|   |   | Dh.Dt. 28.09.2022   |

01 Nr. 018/22  
Më datë: 28.09.2022  
Mamushë

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe 12.2 pika nën d) të Ligjit NR. 03/l-040 për Vetëqeverisje Lokale, dhe Nenit 45.1, pika e) të Statutit të Komunës të Komunës së Mamushës, Kuvendi i Komunës së Mamushës në mbledhjen e mbajtur me 27.09.2022 mori kete:

## V E N D I M

### **Për formimin e Komisionit për caktimin e vendit dhe dizajnit për ndërtimin e lapidarit të dëshmorëve të Mamushës të rënë në luftën e Kosovës (1999)**

#### I

Kuvendi i Komunës së Mamushës në mbledhjen e mbajtur më datë 27.09.2022 e formoi Komisionin për caktimin e vendit dhe dizajnit për ndërtimin e lapidarit të dëshmorëve të Mamushës të rënë në luftën e Kosovës (1999).

#### II

Komisioni formohet në përbërje prej këtyre anëtarëve:

1. Fahriye Kruezi, anëtare e Komisionit;
2. Sakir Mazrek, anëtar i Komisionit;
3. Ramadan Zogaj anëtar i Komisioniot;
4. Cevdet Ozdilmen anëtar i Komisioniot;
5. Sevgi Mazrek. anëtare e Komisionit;

#### III

Komisioni për caktimin e vendit dhe dizajnit për ndërtimin e lapidarit të dëshmorëve të Mamushës të rënë në luftën e Kosovës (1999) e ka për detyrë:

- që ta caktoj vendin për ndërtimin e të dëshmorëve të Mamushës të rënë në luftën e Kosovës (1999) Lapidarit;
- të shpall konkursin për përzgjedhjen e dizajnëve konkurruese për dizajnimet arqitektonik dhe ndërtimore të Lapidarit të dëshmorëve të Mamushës të rënë në luftën e Kosovës (1999);
- Ti parashtroi Raport për aprovim nga Kuvendi i Komunës së Mamushës për përzgjedhjen e vendit si dhe të dizajnit për ndërtimin e lapidarit të dëshmorëve të Mamushës të rënë në luftën e Kosovës (1999);
- Ta caktoj shumën e kushtueshmërisë të procedurës të zgjedhjes së vendit si dhe të dizajnit arqitektonik dhe ndërtimore të Lapidarit të dëshmorëve të Mamushës të rënë në luftën e Kosovës (1999), në bazë të së cilës Kuvendi i Komunës së Mamushës do ti caktoj mjetet buxhetore për të gjitha shpenzimet lidhur me ndarjen e Lokacionit për ndërtimin e Lapidarit, për dizjanimin arqitektonik dhe ndërtimor të Lapidarit të dëshmorëve të Mamushës të rënë në luftën e Kosovës (1999) etj.

Komisioni punën e përcaktuar do ta kryej në afat prej 2 muajve nga dita e marrjes së këtij vendimi

#### IV

Vendimi hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim njoftohen :

- Kryetari i Komunës
- Drejtoria per Buxhet dhe Financa
- Drejtoria për Zhvillim, Planifikim, Urbanizëm dhe Gjeodezi-Kadastër
- Drejtoria e Shërbimeve Publike
- Arkivi;

**Kryesuesi i Kuvendit**

*Necmedin Morina*  
Necmedin Morina

